

**STATUT DHE AKT THEMELIMI  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"JST HOLDINGS" SHPK**

Shoqeria "JST HOLDINGS" SHPK, eshte nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e cila themelohet bazuar ne iniciativen dhe kapitalin e ortakut te vetem themelues respektivisht :

-Thoma Kristo Kostaqi lindur me 04.03.1995 ne Athine,Greqi dhe banues ne Tirane identifikuar nepermjet Leternjoftim ID Nr.Personal J503040900, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Kjo shoqeri krijohet ne baze dhe ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare Te Biznesit", te ndryshuar me Ligjin nr.9916, datë 12.05.2008, Ligjin Nr.92/2012 dhe Ligjin Nr.8/2015.

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Emri i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar eshte "JST HOLDINGS" SHPK  
Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejtat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit . Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e Aktit te Themelimit e te ketij Statuti.

**NENI 2**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

-Shitje dhe sherbim taksi produkte pizza, Bar.

**NENI 3**

**SELIA E SHOQERISE**

Shoqeria ka seline e saj ne "Rruga Adem Sheme", perballe ish-maternitetit ,Sarande .  
Aktiviteti i shoqerise do te zhvillohet ne Sarande dhe do te shtrihet ne te gjithe territorin shtetror te Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

**NENI 4**

**KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise do te jete per nje afat te papercaktuar, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise , te shtoje aksionere sipas vendimit te ortakut te shoqerise .

**NENI 5**

**DETYRIMET E ORTAKEVE**

Ortaku i Shoqerise duhet te kryejne depozitimin e kapitalit themeltar per llogari te Shoqerise ne nje banke te caktuar prej tij.

**NENI 6**

**TRANSFERIMI I KUOTAVE**

Ortaku mund te kaloje pjese nga kapitali themeltar i personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara nga Neni 73 dhe 75 te Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare".

**NENI 7**

**PARAQITJA KONTABILE**

Operacionet e Shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor.

Ne mbyllje te cdo viti Ortaku ose personi i ngarkuar prej tij, bejne inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe hartojne raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e Shoqerise gjate vitit financiar.

**NENI 8**  
**KAPITALI THEMELTAR**

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100 (njqind) Leke, dhe perbehet nga 1 (nje) kuote e vetme , me vlere 100 (njqind) Leke ose 100%.

Shoqeria mund te shtoje ose pakesoje kapitalin e saj deri ne limitin e percaktuar me ligj, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

**NENI 9**  
**OPERACIONET FINANCIARE**

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

**NENI 10**  
**BLERJET E SHOQERIVE**

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e Shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, Shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo Shoqeri tjetere ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret Dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.

**NENI 11**  
**PLANET FINANCIARE DHE FONDI REZERVE**

Shoqeria mund te themeloje nje fond rezerve si dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin e saj. Perberja, shuma totale, fondet per krijimin e tyre perdorimi dhe rregullimi i tyre (i cdo fondi) percaktohet nga Ortaket ne perputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale te Shoqerise raportohen ne bilance te shprehur ne Leke, ne perputhje me rregullat ne fuqi ne Republiken e Shqiperise. Bilanci dhe perllogaritjet ekonomike te Shoqerise hartohen mbi bazen e formes se bilancit dhe llogaritjeve ekonomike te percaktuara per shoqerite tregtare ne Shqiperi. Bilanci vjetor mbyllet ne 31 dhjetor te cdo viti.

Aktiviteti i Shoqerise mbi bazen e programeve financiare qe bejne pjese ne aktivitetin financiar te saj. Planet financiare parashikojne koston dhe te ardhurat e shprehura ne Leke. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do te paraqiten ne Leke. Rezultatet financiare te aktivitetit dhe te punes se kryer nga Shoqeria, paraqiten ne bilancin vjetor. Kursi i kembimit te monedhes shqiptare ne monedhat e huaja dhe e kunderta do te jene ato te vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar.

**NENI 12**  
**ORGANET E SHOQERISE**

Organet e shoqerise do te jene:

- Ortaku i vetem.
- Administratori

**NENI 13**  
**ORTAKU I VETEM**

- 1) Ortaku i vetem i shoqerise Thoma Kristo Kostaqi zoteron 100% te kapitalit te shoqerise.
- 2) Ortaku i vetem eshte organi vendimarrës i shoqerise dhe eshte pergjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerine për çështjet e mëposhtme:
  - a. percaktimin e politikave tregtare të shoqerise;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit;
  - d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e. percaktimin e shperblimeve për personat e permenduar në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f. mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, perfshirë pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit;
  - i. pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. perfaqesimin e shoqerise në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
  - l. miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të Shoqerise;
  - m. çështjet të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

3) Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër vendimesh që mbahet nga Administratori dhe të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b. shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c. investime; dhe
- d. vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

#### **NENI 14**

##### **ADMINISTRATORI I SHOQERISE**

Shoqëria do të drejtohet nga administratori i saj, njëkohësisht dhe ortak i vetëm Z.Thoma Kristo Kostaqi. Afati i qëndrimit në detyrë të Administratorit është për një periudhë 5 (pese) vjetore, përveç rasteve të dorëheqjes së tij nga detyra e administratorit apo revokimit të tij nga detyra dhe emërimin e një administratori të ri nga ortaku i vetëm i Shoqërisë.

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të Shoqërisë, në të gjitha rrethanat dhe ka kompetencë të plotë në drejtimin e saj, përveç atyre të cilat ligji ia nënshprehimisht Asamblese së Ortakeve. Administratori ka përgjegjësi ndaj Shoqërisë ose ndaj të treteve për shkelje të Ligjeve, Statutit apo shkeljeve të kryera gjatë administrimit.

Administratori i shoqërisë duhet të verifikojë rregullsinë e mbledhjeve.

#### **NENI 15**

##### **MBLEDHJET DHE MENYRA E THIRRJES SE MBLEDHJEVE**

-Ortaku i vetëm i Shoqërisë mund të organizojë mbledhje të zakonshme.

-Mbledhjet e zakonshme thirren të paktën dy herë në vit, pas mbylljes së vitit financiar dhe kur aprovohet programi i veprimtarisë për vitin e ardhshëm.

-Mbledhjet e zakonshme mund të thirren edhe kur ortaku i vetëm e quan të përshtatshme për kërkesat e shoqërisë.

-I takon ortakut të vetëm, që, përmes një vendimi në përfundim të mbledhjes së zakonshme të bëjë ndryshime në Statutin e Shoqërisë, të paksojë ose shtojë kapitalin themelor, të shtojë aksionere, të shpërndaj shoqërinë përpara afatit, ose të shtyjë aktivitetin e saj. Vendimet e ortakut të vetëm të marra në përputhje me ligjin dhe me këtë statut janë të detyrueshme.

-Për të mbajtur procesverbalin e mbledhjeve caktohet një sekretar që mund të jete dhe një noter. Vendimet e ortakut të vetëm duhet të nënshkruhen nga Administratori i shoqërisë, dhe nga ortaku i vetëm.

#### **NENI 16**

##### **PUNESIMET NE SHOQERI**

Raportet e punës ndërmjet Shoqërisë, filialeve dhe agjensive të saj si dhe të punonjësve në të, rregullohen në bazë të Kontrates së Punës, konform Kodit të Punës.

Për sa nuk parashikohet në keto Kontrata, aplikohen dispozitat e legjislationit shqiptar në fuqi.

#### **NENI 17**

##### **SHLYERJA E DETYRIMEVE**

Shoqëria merr përsipër, të shlyej rregullisht të gjitha detyrimet e saj që burojnë nga legjislationi për sigurimet shoqërore e shëndetësore lidhur me të punësuarit e saj.

#### **NENI 18**

##### **PERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

Shoqëria prishet:

- 1.Me kalimin e afatit për kohezgjatjen e saj.
2. me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- 3.Për pamundësi të realizimit të objektivit të saj.
- 4.Me vendim gjykatë.
- 5.Me hapje të procedurave të falimentit.
6. Me shpalljen e paafesise apo vdekjen e ortakut të vetëm, në rast se në një kohë të mëvonshme nga krijimi do të jete me shumë se një ortak (shoqëria nuk prishet kur njëri prej ortakëve falimenton, bëhet i paafte ose vdes.)

**NENI 19**  
**LIKUJDIMI**

Likujdimi i Shoqerise behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

**NENI 20**  
**ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE**

Te gjithë mosmarreveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likujdimit,ne rast se nuk zgjidhen apo nuk mund te zgjidhen me marveshje dhe mirkuptim mes paleve , do ti paraqiten per zgjidhje gjykates kompetente.

**NENI 21**  
**KUSHTET E TJERA**

Te gjitha vendimet e mara nga Asambleja evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e Shoqerise.

Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete Statut do ti referohen plotesimeve qe mund te bejne Ortaket si dhe Ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky statut u hartua ne dy kopje ne gjuhen Shqipe, duke patur secila kopje fuqi te njejte ligjore.

Per regjistrimin e Shoqerise dhe depozitimin e akteve prane QKB, autorizohet Administratori i saj.

Nënshkruar, sot më datë 19.10.2020

**ORTAKU THEMELUES**

Z. Thoma Kristo Kostaqi

Shoqeria "JST HOLDINGS" shpk  
Administrator  
Thoma Kristo Kostaqi

